REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson z.ja Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë; dhe

"URANIKU-SG" SHPK, të cilën e përfaqëson, i autorizuari z. Smajl Gashi, nga Buqani, Komuna e Pejës me nr. Unik të Biznesit, 810409012 (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për pune e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

FURNIZIMI DHE MONTIMI I PAISJEVE PËR NGROHJE QENDRORE PËR KOPSHTET E FËMIJËVE "LULET E JETËS" DHE "ARDHMËRIJA JONË"

Nr. I prokurimit	**633 – 20 – 7120– 1 2 1**
I brendshëm	**633-020 / 126 / 121**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është furnizimi dhe instalimi i paisjeve si në vijim:

FURNIZIMI DHE MONTIMI I PAISJEVE PËR NGROHJE QENDRORE PËR KOPSHTET E FËMIJËVE "LULET E JETËS" DHE "ARDHMËRIJA JONË"

2 Çmimi

2.1 Çmimi i kësajë kontrate në total është: **5.982,00 €**
dhe me fjalë **/Pesëmijëenëntëçindetetëdhjedyeuro/**

2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani per meaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4. Afati i përmbushjës së kontratës:

4.1 Kontrata do të përmbushet ne afat prej 30 ditësh, nga data e nënshkrimit te se njëjtës, e më së larti deri me: 24.12.2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk permbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të përgjigjet për dëmet eventuale që mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për

pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:

"URANIKU-SG" SHPK

Emri:	***Gëzim Ademaj***	***Emri:***	***Smajl Gashi***
Pozita:	***U.D.*** ***Menaxher-it Prokurimit***	***Pozita:***	***D r e j t o r***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	04. 12. 2020	***Data:***	04. 12. 2020
Vula:		***Vula:***	

A	**FTOHJA DHE NGROHJA ME SPLIT KLIMA**					
	Klima inverter Gree					
1	Furnizimi dhe montimi i klimave Gree Inverter, Lomo best buy me mundesi kyqje me WIFI,njesi e mbrendeshme dhe e jashtme, model: me Dim:845-289-209,848-596-320 Qf/n=3.5/3,7kW, **12000 BTU**, ose te ngjashme. 2 në Vrellë, 2 ne Gurakovc dhe 4 në Banjë		copë	8	400.00	3,200.00 €
2	Gypa e bakrit per freon Ø6.8 mm me Izolim		m'	120	0.50	60.00 €
3	Gypa e bakrit per freon Ø9.52 mm me Izolim		m'	120	0.80	96.00 €
4	Gyp kondenzati Ø20 mm mbajtesa si dhe kabllimi		m'	130	0.20	26.00 €
5	Furnizimi dhe montimi i shporetit se bashku me furren per ngrohje me kapacitet Q=20-30 kW se bashku me te gjitha elementet percjellese si pompa ena valvola		copë	2	1,300.00	2,600.00 €
				TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT		**5,982.0 €**

Në rast se në Specifikimin Teknik(pershkrim te cmimeve) të cekur më lartë i jemi referuar ndonjë artikulli të veçantë, brendi, marke tregtarë apo shenje dalluese për ta qartësuar më saktë specifikimin ne fjalë, në të gjitha këto rast vlenë edhe "apo ekuivalent".